

PHILIPS

Boks për festa

Seria 5000

TAX5206



Manuali i përdorimit

Regjistroni produktin tuaj dhe merrni ndihmë në:
www.philips.com/support

Përmbajtja

1 Të rëndësishme	2	9 Hyrja e kitarës	12
Siguria	2	Rregullimi i volumit të kitarës	12
Informacioni FCC	3		
2 Boksi për festa	4	10 Karikimi me USB	13
Çfarë ka në kuti	4	Karikimi i një pajisjeje të jashtme	13
Përmbledhje e njësive kryesore	5		
Luajtja bazë	6	11 Informacione për produktin	14
3 Fillimi	7	Specifikime	14
Lidhja e energjisë	7	Mirëmbajtja	14
Rregullimi i bass dhe treble	8		
Karikimi i baterisë së brendshme	8	12 Zgjidhja e problemeve	15
4 Ndryshimi i efektit të dritës	9	Informacion rreth pajisjes me Bluetooth	15
Ndezja ose fikja e dritës dekorative	9		
5 Luajtja e audios nëpërmjet Bluetooth	9	13 Njoftim	16
Lidhja e një pajisjeje	9	Deklarata e konformitetit	16
Lidhja e një pajisjeje automatikisht	9	Kujdesi për mjedisin	16
Lidhja e një pajisjeje manualisht	9	Njoftim për markën tregtare	16
Shkëputja e një pajisjeje	10		
6 Luajtja e audios nëpërmjet USB	10		
Luajtja nga një pajisje ruajtëse USB	10		
Kontrolli i luajtjes	11		
Rregullimi i volumit	11		
Informacione për luajtjen nga USB	11		
Formatet MP3 që mbështeten	11		
7 Luajtja e audios nëpërmjet linjës hyrëse	11		
Dëgjimi i një pajisjeje të jashtme	11		
Luajtja nga një aparat MP3	11		
Linja dalëse	11		
8 Të këndosh nëpërmjet mikrofonit	12		
Rregullimi i volumit të mikrofonit	12		
Rregullimi i jehonës	12		
Zbehësi vokal	12		
Ndryshuesi i zërit	12		

1 Të rëndësishme

Siguria

Njihuni me këto simbole sigurie



Kjo "rrufe" tregon se materiali i paizoluara brenda pajisjes mund të shkaktojë goditje elektrike. Për sigurinë e të gjithëve në familjen tuaj, mos e hiqni kasën e produktit.

"Pikëçuditja" tërheq vëmendjen ndaj veçorive, për të cilat duhet të lexoni me kujdes literaturën e përfshirë me qëllim që të parandaloni problemet me përdorimin dhe mirëmbajtjen.

PARALAJMËRIM: Për të pakësuar rrezikun e zjarrit ose goditjeve elektrike, ky aparat nuk duhet të ekspozohet ndaj shiut ose lagështisë, dhe objektet me lëngje, siç mund të jenë vazot nuk duhen vendosur mbi këtë aparat.

KUJDES: Për të parandaluar goditjet elektrike, puthiteni kunjin e gjerë të spinës me vrimën e gjerë, dhe futeni plotësisht.



Paralajmërimin

- Asnjëherë mos e hiqni kasën e kësaj pajisjeje.
- Mos lubrifroni asnjëherë asnjë pjesë të kësaj pajisjeje.
- Asnjëherë mos e vendosni këtë pajisje mbi pajisje të tjera elektronike.
- Mbajeni këtë pajisje larg nga drita direkte e diellit, flakët ose nxehtësia.
- Asnjëherë mos shikoni te rrezja e laserit brenda kësaj pajisjeje.
- Sigurohuni që ta arrini gjithnjë me lehtësi kordonin e energjisë, spinën ose adaptorin për ta shkëputur pajisjen nga energjia.

- Mos e përdorni këtë aparat pranë ujit.
- Instaloni sipas udhëzimeve të prodhuesit.
- Mos e instaloni pranë asnjë burimi nxehtësie si për shembull radiatorë, pajisje ngrohjeje, soba, ose pajisje të tjera që prodhojnë nxehtësi (përfshirë edhe amplifikatorët).

- Mbrojeni kordonin e energjisë në mënyrë që të mos shkelet ose të mos kafshohet padashur te spina, priza, dhe në pikën ku del nga pajisja.
- Përdorni vetëm shtesa/aksesorë të specifikuar nga prodhuesi.
- Përdorni vetëm me karrocë, mbajtëse, tripod, kllapë ose tavolinë të specifikuar nga prodhuesi, ose që shitet bashkë me pajisjen.
- Kur përdoret karrocë, bëni me kujdes kur lëvizni karrocën bashkë me aparatin për të mos rrezikuar që ta rrëzoni.



- Shkëputeni këtë pajisja nga priza gjatë stuhive me vetëtimë ose kur nuk përdoret për kohë të gjatë.
- Vetëm personeli i kualifikuar duhet t'i bëjë riparime. Riparimet kërkohen kur pajisja është dëmtuar në ndonjë mënyrë, si për shembull kordoni ose spina e energjisë është dëmtuar, është derdhur lëng ose kanë rënë objekte brenda në pajisje, pajisja është ekspozuar ndaj shiut ose lagështisë, nuk punon normalisht, ose është rrëzuar.
- Kujdes lidhur me përdorimin e baterisë — Për të parandaluar rrjedhjet e baterive të cilat mund të shkaktojnë lëndime, dëmtime të pronës ose dëmtime telekomandës:
 - Montojini të gjitha bateritë si duhet, + dhe - siç janë shënuar në telekomandë.
 - Mos i përzieni bateritë (të reja me të vjetrat, ose ato prej karboni me ato alkaline, etj.).
 - Hiqini bateritë kur telekomanda nuk përdoret për kohë të gjatë.
- Bateria nuk duhet të ekspozohet ndaj dritës direkte të diellit, zjarrit ose burimeve të ngjashme të nxehtësisë.
- Pajisja nuk duhet të ekspozohet ndaj pikave ose spërkatjeve.
- Mos vendosni asnjë burim rreziku mbi pajisje (p.sh. objekte të mbushura me lëng, qirinj të ndezur).
- Aty ku spina e energjisë ose një bashkues i pajisjes përdoret për si mjet shkëputjeje, pajisja e shkëputjes duhet të jetë në një vend që arrihet me lehtësi.



Kujdes

- Përdorimi i kontrolleve, bërja e rregullimeve ose ndjekja e procedurave të ndryshme nga ato që tregohen këtu mund të shkaktojë ekspozim të rrezikshëm ndaj laserit ose punim të rrezikshëm.

Siguria e dëgjimit



Dëgjoni me volum mesatar

- Përdorimi i kufjeve në volum të lartë mund t'ju dëmtojë dëgjimin. Ky produkt mund të krijojë tinguj në nivele decibeli aq të larta sa të shkaktojë humbje të dëgjimit për një person normal, qoftë edhe nga ekspozimi për më pak se një minutë. Nivelet e larta të decibelit shërbejnë për ata persona që kanë pësuar tashmë humbje të dëgjimit për shkaqe të tjera.
- Tingulli mund të jetë mashtrues. Me kalimin e kohës, "niveli i rehatshëm" i dëgjimit përshtatet me volumet e larta. Prandaj, pas dëgjimit për kohë të gjatë, volumi që ju duket "normal" mund të jetë tepër i lartë dhe mund t'ju dëmtojë dëgjimin. Për t'u mbrojtur, vendoseni volumin në nivel të sigurt para se të përshtateni me atë lloj volumi, dhe lëreni aty.

Për të përcaktuar një nivel të sigurt volumi

- Vendoseni kontrollin e volumit në nivel të ulët.
- Rriteni me ngadalë volumin derisa ta dëgjoni rehat dhe qartë pa deformime.

Dëgjoni për periudha kohe të arsyeshme

- Ekspozimi ndaj tingujve për kohë të gjatë, edhe në nivele që normalisht janë të sigurta, mund të shkaktojë humbje dëgjimi.
- Sigurohuni që t'i përdorni pajisjet tuaja në mënyrë të arsyeshme dhe të bëni pushime të përshtatshme.

Sigurohuni të ndiqni udhëzimet e mëposhtme kur i përdorni kufjet

- Dëgjoni me volum të arsyeshëm dhe për periudha kohe të arsyeshme.
- Bëni kujdes të mos e rritni volumin ndërkohë që ju përshtatet dëgjimi.
- Mos e ngrini volumin aq shumë sa të mos dëgjoni çfarë ndodh rreth jush.
- Ju duhet të përdorni kujdes ose të ndërpriteni përkohësisht përdorimin në situatave të mundshme të rrezikshme.



Shënim

- Etiketa e të dhënave ndodhet mbrapa pajisjes.

Informacioni FCC

SHËNIM: Kjo pajisje është testuar dhe është zbuluar se i përmbahet limiteve për një pajisje digjitale të Klasit B, sipas pikës 15 të rregullave FCC. Këto limite janë vendosur për të siguruar mbrojtje të arsyeshme ndaj interferencave të dëmshme në një ambient banimi. Pajisja gjeneron, përdor dhe mund të rrezatojë energji të frekuencave radio dhe, nëse nuk instalohet dhe nuk përdoret sipas udhëzimeve, mund të shkaktojë interferenca të dëmshme ndaj komunikimeve radio. Megjithatë, nuk ka garanci se nuk do të ketë interferenca në një ambient të caktuar. Nëse kjo pajisje shkakton interferenca të dëmshme ndaj sinjalit të radios ose televizionit, gjë që mund të përcaktohet duke e o dhe ndezur pajisjen, përdoruesi nxitet që të përpikët ta korrigjojë interferencën duke ndjekur një ose më shumë nga masat e mëposhtme:

- Ndryshoni orientimin ose lëvizni antenën.
- Largojeni pajisjen nga marrësi.
- Lidheni pajisjen në një prizë që ndodhet në një qark të ndryshëm nga ai në të cilin është lidhur marrësi.
- Konsultohuni me shitësin ose me një teknik me përvojë për bokse/televizorë.

Kjo pajisje është në përputhje me pikën 15 të rregullave FCC. Përdorimi i nënshtrohet dy kushteve të mëposhtme: (1) kjo pajisje nuk duhet të shkaktojë interferencë të dëmshme, dhe (2) kjo pajisje duhet të pranojë çdo interferencë të marrë, duke përfshirë interferencat që mund të shkaktojnë operim të padëshiruar.

IC-Kanada: CAN ICES-3(B)/NMB-3(B)

Kjo pajisje përmban transmetues/marrës të përjashtuar nga licencat të cilat i përmbahen RSS-ve të Inovacionit, Shkencës dhe Zhvillimit Ekonomik të Kanadasë të përjashtuar nga licencat. Përdorimi i nënshtrohet dy kushteve të mëposhtme:

1. Kjo pajisje nuk mund të shkaktojë interferenca.
2. Kjo pajisje duhet të pranojë çfarëdo interference, duke përfshirë interferencat që mund të shkaktojnë punim të padëshiruar të pajisjes.

2 Boksi për festa

Urime për blerjen tuaj, dhe mirë se vini në Philips!
Për të përfituar plotësisht nga mbështetja që jep
Philips, regjistroni produktin në
www.philips.com/support.


Çfarë ka në kuti

Kontrolloni dhe dalloni gjërat që ka në kuti:

- Njësia kryesore
- Kordoni i energjisë AC
- Manuali i përdorimit
- Dokumenti për sigurinë
- Karta e garancisë

Përmbledhje e njësisë kryesore


Paneli i sipërm:



- | | |
|---------------------------------|---------------------------------------|
| 1 USB play (Luajtja nga USB) | 12 Volumi - |
| 2 Guitar in (Hyrja e kitarës) | 13 Treguesi i nivelit të baterisë |
| 3 Mic in (Hyrja e mikrofonit) | 14 Luaj/Pauzë |
| 4 Guitar vol (Volumi i kitarës) | 15 Bluetooth (treguesi blu) |
| 5 Mic vol (Volumi i mikrofonit) | 16 Tjetra |
| 6 Echo (Jehona) | 17 Light (Drita) |
| 7 Vocal fader (Zbehësi vokal) | 18 Voice changer (Ndryshuesi i zërit) |
| 8 Volumi + | 19 Bass |
| 9 Mute (Heshtje) | 20 Treble |
| 10 E mëparshme | 21 Line out (Linja dalëse) |
| 11 Në pritje (treguesi i kuq) | 22 Line in (Linja hyrëse) |

Përmbledhje e njësise kryesore

Paneli i pasmë:



- 1 Karroca
2 Priza e energjisë AC

Luajtja bazë



- Mbajeni shtypur për 3 sekonda për ta ndezur/fikur pajisjen.
- Shtypeni për të kontrolluar nivelin e baterisë ndërkohë që pajisja është e ndezur.



- Shtypeni vazhdimisht për ta aktivizuar ose çaktivizuar zbehësin vokal.



- Rotulloni çelësin **Bass** për të rregulluar nivelin e bass-it.



- Rotulloni çelësin **Treble** për të rregulluar nivelin e treble.



- Shtypeni vazhdimisht për të kaluar mes toneve të zërit: zëri1/zëri2/zëri3/zëri4/zëri fikur.



- Shtypeni vazhdimisht për të ndryshuar modalitetin e dritës së boksit. Mbajeni shtypur për të ndezur/fikur dritën pulsuese.



- Shtypeni për të kaluar te kënga tjetër.



- Shtypeni për t'u kthyer te kënga e mëparshme.



- Shtypeni për të rritur volumin.



- Shtypeni për të ulur volumin.



- Shtypeni për të hyrë në modalitetin e Bluetooth. Mbajeni shtypur për të shkëputur lidhjen e Bluetooth.



- Shtypeni për të ndaluar përkohësisht luajtjen; shtypeni përsëri për të vazhduar luajtjen.



- Aktivizoni ose çaktivizoni heshtjen.



- Rotullojeni për të rregulluar volumin e mikrofonit.



- Rregullojeni për të rregulluar jehonën e mikrofonit.

3 Fillimi



- Vendosni një pajisje ruajtëse USB për luajtjen e audios.



- Rrotulloni çelësin **Guitar vol** për të rregulluar volumnin e kitarës (nëse është lidhur).

Mic in



- Hyrja e mikrofinit.

Guitar in



- Hyrja e kitarës.

Line in



- Lidhni një pajisje të jashtme nëpërmjet xhekut **Line in** për të luajtur audio.

Line out



- Nxirrni audio në një pajisje të jashtme nëpërmjet xhekut **Line out**.



Kujdes

- Përdorimi i kontrolleve, bërja e rregullimeve ose ndjekja e procedurave të ndryshme nga ato që tregohen këtu mund të shkaktojë ekspozim të rrezikshëm ndaj laserit ose punim të rrezikshëm.

Ndiqui gjithnjë me radhë udhëzimet në këtë kapitull.

Nëse kontakti Philips, do të pyeteni për numrin e modelit dhe të serisë së kësaj pajisjeje. Numri i modelit dhe i serisë ndodhen mbrapa pajisjes. Shkruani numrat këtu:

Nr. i modelit _____

Nr. i serisë _____

Lidhja me energjinë



Kujdes

- Rrezik i dëmtimit të produktit! Sigurohuni që tensioni i energjisë përputhet me tensionin që është shkruar poshtë produktit.
- Rrezik goditjeje elektrike! Kur e shkëputni kordonin e energjisë, tërhiqni gjithnjë spinën nga priza. Asnjëherë mos tërhiqni kordonin.




Shënim

- Para se të lidhni energjinë AC, sigurohuni që të keni kryer të gjitha lidhjet e tjera

Lidhni kordonin e energjisë AC me prizën AC në panelin e pasmë të pajisjes.

Më pas lidhni anën tjetër të kordonit të energjisë AC në një prizë energjie.



Gjatësia e kordonit dhe lloji i spinës ndryshojnë në varësi të rajonit.

Ndezja

Shtypni 

➔ Mbajeni shtypur për 3 sekonda për ta ndezur/fikur boksën e festave.

Shënim

- Boksi i festave do të hyjë gjithnjë në modalitetin e çiftimit me Bluetooth çdo herë që e ndizni.



Rregullimi i bass dhe treble

Rrotulloni çelësin **Bass** për të ndryshuar nivelin e bass-it. Rrotullojeni në drejtim të akrepave të orës për të rritur nivelin e bass-it, dhe në drejtim të kundërt të akrepave të orës për ta ulur nivelin e bass-it. Rrotulloni çelësin **Treble** për të rregulluar nivelin e treble. Rrotullojeni në drejtim të akrepave të orës për të rritur nivelin, dhe rrotullojeni në drejtim të kundërt të akrepave të orës për ta ulur nivelin.

Karikimi i baterisë së brendshme

- Lidhni kordonin e energjisë AC për të karikuar baterinë e brendshme. Treguesit e baterisë pulsojnë në mënyra të ndryshme për të treguar gjendjen e karikimit.



Shënim: Katër treguesit në pajisje do të fiken për 15 sekonda pasi bateria të jetë karikuar plotësisht.



- Për lehtësinë tuaj, boksën është projektuar me një veçori inteligjente të kontrollit të baterisë.
- Shtypni butonin  për të shfaqur nivelin aktual të baterisë në treguesit LED të pajisjes në gjendje të ndezur ndërkohë që pajisja nuk është duke u karikuar.

4 drita LED të bardha ndizen = rreth 100% plot
3 drita LED të bardha ndizen = rreth 80% plot
2 drita LED të bardha ndizen = rreth 50% plot
1 drita LED të bardha ndizen = rreth 20% plot
(tregon që ka nevojë për karikim)


Shënim: Kur niveli i baterisë është i ulët, të gjithë treguesit LED të baterisë pulsojnë njëkohësisht dhe dëgjohej një tingull.



4 Ndryshimi i efektit të dritës

Ndizni ose fikni dritën dekorative

1. Në gjendje të ndezur, shtypni vazhdimisht butonin **Light** për të kaluar mes modaliteteve të ndryshme të dritës së boksit.
2. Në gjendje të ndezur, mbani shtypur butonin **Light** për 3 sekonda për ta ndezur/fikur dritën pulsuese.



5 Luajtja e audios nëpërmjet Bluetooth

Produkti mund të përcjellë muzikë nga pajisja juaj me Bluetooth te sistemi nëpërmjet Bluetooth.

Lidhja e një pajisjeje

Shënim

- Para se të çiftoni një pajisje me këtë produkt, lexoni manualin e përdorimit për të ditur pajtueshmërinë e Bluetooth.
- Produkti mund të mbajë mend deri në tetë pajisje të çiftuara. Pajisja e nëntë e çiftuar do të zëvendësojë të parën.
- Çdo pengesë mes këtij produkti dhe një pajisjeje me Bluetooth mund të pakësojë distancën e punimit. Mbajeni larg nga çdo pajisje elektronike që mund të shkaktojë interferenca.
- Distanca e mundshme funksionale mes këtij produkti dhe një pajisjeje me Bluetooth është rreth 10 metra.

Lidhja e një pajisjeje automatikisht

1. Mbani shtypur butonin  për 3 sekonda për ta ndezur boksit e festave. Pajisja hyn automatikisht në modalitetin e çiftimit me Bluetooth, dhe drita e pasme blu e butonit  dhe drita blu e boksit pulsojnë për t'ju kujtuar që të lidheni me një pajisje me Bluetooth.
2. Në pajisjen tuaj Bluetooth, aktivizoni Bluetooth dhe kërkoni pajisjet Bluetooth që mund të lidhen.
3. Zgjidhni **[Philips TAX5206]** shfaqet në pajisjen tuaj për çiftim. Pas lidhjes me sukses, drita e pasme blu e butonit  qëndron ndezur.

Lidhja e një pajisjeje manualisht

1. Kur boksit e festave është në burimin e USB ose të linjës hyrëse, shtypni shkurtimisht butonin  për të kaluar te burimi Bluetooth dhe për të hyrë te modaliteti i çiftimit. Drita e pasme blu e butonit  dhe drita blu e boksit pulsojnë për t'ju kujtuar që të lidheni me një pajisje me Bluetooth.
2. Në pajisjen tuaj Bluetooth, aktivizoni Bluetooth dhe kërkoni pajisjet Bluetooth që mund të lidhen.

- 3 Zgjidhni **[Philips TAX5206]** shfaqet në pajisjen tuaj për çiftim. Pas lidhjes me sukses, drita e pasme blu e butonit  qëndron ndezur.

Shkëputja e një pajisjeje

- 1 Mbani shtypur butonin  në boksen e festave për 3 sekonda për ta shkëputur nga pajisja aktuale.
- 2 Drita e pasme blu e butonit  dhe drita blu e boksit pulsojnë për t'ju kujtuar që të lidheni me një pajisje me Bluetooth.

Shënim

- Para se të lidhni një pajisje tjetër me Bluetooth, shkëputni pajisjen aktuale në fillim.
- Kur pajisja me Bluetooth është përtej distancës së vlefshme të Bluetooth, pajisja do të shkëputet automatikisht nga pajisja tjetër.
- Mbani shtypur butonin  në pajisje për 8 sekonda për ta shkëputur pajisjen aktuale dhe për të fshirë informacionet e çiftimit me Bluetooth.


6 Luajtja e audios nëpërmjet USB

Luajtja nga një pajisje ruajtëse USB

Shënim

- Sigurohuni që pajisja me Bluetooth përmban materiale audio në formate të pranueshme që mund të luhen. Formatet e pranueshme: MP3, WAV, WMA, FLAC. Formatet audio FLAC mbështet jo më tepër se 16 bit rate dhe 1M code rate. Pajisja mbështet USB 128G dhe format skedari FAT16/FAT32/exFAT.
- Nëse pajisja USB nuk njihet dhe është e palexueshme ose materiali i audios në USB nuk mund të luhet, boks i festave do të kalohet automatikisht te burimi i Bluetooth.

- 1 Mbani shtypur butonin  për 3 sekonda për ta ndezur boksen e festave dhe më pas do të dëgjoni një tingull lajmërues.
- 2 Vendosni spinën USB të pajisjes te foleja USB.
- 3 Drita e pasme blu e butonit  do të fiket dhe boks i festave do të kalohet automatikisht te burimi USB.
- 4 Luani këngën automatikisht.



Shënim

- Duhet të futni përsëri spinën USB në fole nëse doni të kaloni përsëri në USB nga burime të tjera.

Kontrolli i luajtjes

Në modalitetin e USB, ndiqni udhëzimet e mëposhtme për të kontrolluar luajtjen.

Butoni	Veprimi
⏮ / ⏭	Shtypeni për të kaluar te kënga e mëparshme ose kënga tjetër.
+ / -	Rritni/ulni volumnin.
⏸	Shtypeni për të ndaluar ose vazhduar luajtjen.

Rregulloni volumnin

Gjatë luajtjes, shtypni butonin +/- në boksën e festave për të rritur ose ulur volumnin.

Drita jeshile e boksit do të ndryshojë për të treguar rregullimin e volumnit.

Informacione për luajtjen nga USB

Pajisjet e pajtueshme USB:

- Memorie flash USB (USB 2.0)
- Aparate flash USB (USB 2.0)
- Karta memorieje (nevojitet një lexues karte që të punojë me këtë pajisje)

Formatet e pranueshme:

- Formati i skedarit të USB ose memories: FAT16, FAT32, exFAT (madhësia e sektorit: 512 bytes)
- Formati audio: MP3, WAV, WMA, FLAC.
- Direktoria mban deri në 8 nivele
- Mbështetje maksimale deri në 128G USB

Formatet MP3 që mbështeten

- Nr. maksimal i pllakave: 999 (në varësi të gjatësisë së emrit të skedarit)
- Nr. maksimal i albumeve: 64
- Frekuencat Sampling që mbështeten: 32 kHz, 44.1 kHz, 48 kHz
- Bit-rate që mbështeten: Bit rate të ndryshueshme 32-384 (kbps)


7 Luajtja e audios nëpërmjet linjës hyrëse

Dëgjimi i një pajisjeje të jashtme

Me këtë produkt mund të dëgjoni një pajisje audio të jashtme, si për shembull një aparat MP3.

Luajtja nga një aparat MP3

- 1 Mbani shtypur butonin  për 3 sekonda për ta ndezur boksën e festave dhe më pas do të dëgjoni një tingull lajmëruës.
- 2 Lidhni një kablo hyrjeje audio (nuk është dhënë) me një konektor 3.5 mm në të dyja anët me:
 - Xhekun **Line in** në produkt.
 - Xhekun e kufjeve në aparatin MP3.
- 3 Drita e pasme blu e butonit  do të fiket dhe boksë i festave do të kalohet automatikisht te burimi i linjës hyrëse.
- 4 Luani audio në aparatin MP3 (shikoni manualin e tij të përdorimit)



Shënim

- Duhet të futni përsëri kablalin e hyrjes së audios të xheku **Line in** nëse doni të kaloni përsëri te linja hyrëse nga burime të tjera.

Line out

Pajisja ka një xhek **Line out**. Mund të nxirri sinjale analoge stereo të audios në pajisje të jashtme, si për shembull në një boks aktiv. Lidhni një kablo audio (nuk është dhënë) me xhekun **Line out** në panelin e sipërm të xhekut të linjës hyrëse të pajisjes së jashtme, dhe pajisja do të nxjerrë audio automatikisht te pajisja e jashtme.

8 Të këndosh nëpërmjet mikrofonit

Rregullimi i volumit të mikrofonit

Lidhni një mikrofon (nuk është dhënë) me xhekun **Mic in** të pajisjes, dhe rregulloni volumin e mikrofonit duke rrotulluar çelësin **Mic vol.** Tani kënaquni duke kënduar karaoke.

Rregullimi i jehonës

Rregulloni nivelin e jehonës së mikrofonit sipas nivelit të dëshiruar duke rrotulluar çelësin **Echo** në panelin e sipërm.

Zbehësi vokal

Shtypni butonin **Vocal fader** në panelin e sipërm për të aktivizuar dhe çaktivizuar zbehësin vokal.

Ndryshuesi i zërit


Shtypni butonin **Voice changer** në panel për të kaluar mes toneve të ndryshme të zërit: zëri1/zëri2/zëri3/zëri4/zëri i çaktivizuar

9 Hyrja e kitarës

Rregullimi i volumit të kitarës

Mund të lidhni një kitarë me këtë boks festash direkt nëpërmjet xhekut **Guitar in** në panelin e sipërm.

- 1 Përdorni një konektor kitare 6.3 mm (1/4") (nuk është dhënë) për ta lidhur kitarën me xhekun **Guitar in**.
- 2 Volumi i kitarës së lidhur mund të kontrollohet nëpërmjet çelësit **Guitar vol** në panelin e sipërm.



10 Karikimi me USB

Karikimi i një pajisjeje të jashtme


Me këtë boks festash mund të karikoni pajisje të jashtme, si për shembull celularin.

- 1 Lidhni celularin me boksën e festave nëpërmjet kabllot USB (nuk është dhënë).
- 2 Lidhni boksën e festave me energjinë.

Karikimi fillon pasi të njihet telefoni.

Shënim

- Karikimi me USB mbështet vetëm karikimin në dalje prej 5 V, 1 A. Nuk mbështet karikimin e pajisjeve me rrymë më të madhe karikimi, si iPad etj.



11 Informacione për produktin

Specifikime

Amplifikatori

Fuqia AC në dalje (RMS)	80 W
Fuqia AC në dalje (maksimale)	160 W
Fuqia e baterisë në dalje	30 W
Përgjigja e frekuencës	40 Hz-20 KHz,-12 dB
Raporti sinjal-zhurmë	≥ 65 dBA
Shtrembërimi total harmonik	≤10 %

Boksi

Impedanca e boksit	4 ohm
Ndjeshmëria	91 dB ± 3 dB/m/W

USB

Versioni i USB direct	2.0 Full Speed
Karikimi	5 V, 1 A

Bluetooth

Versioni i Bluetooth	V5.0
Banda e frekuencës së Bluetooth	2.402 GHz ~ 2.480 GHz ISM Band
Rrezja e Bluetooth	10 m (hapësirë e lirë)

Formati i streaming: SBC, music streaming (A2DP),
Kontrolli i luajtjes/volumit: AVRCP
Mbështetje multipoint (multipair):

Bateria

Kapaciteti i baterisë	E brendshme, e karikueshme 7.4 V 4400 mAh
-----------------------	---

Informacione të përgjithshme

Energjia AC	100-240 V~, 50/60 Hz
Konsumi ekologjik në gjendje joaktive	≤ 0.5 W

Përmasat

Njësia kryesore (Gje x La x Tra)	309 x 700 x 322 mm
-------------------------------------	--------------------

Pesha

Njësia kryesore	10.52 kg
-----------------	----------

Mirëmbajtja

Pastroni kabinetin

- Përdorni një leckë të butë të njomur pak me
solucion detergjenti të lehtë.
Mos përdorni solucion që përmban alkool,
amoniak ose lëndë gërryese.

12 Zgjidhja e problemeve

Kujdes

- Asnjëherë mos e hiqni kasën e kësaj pajisjeje.

Për ta mbajtur garancinë të vlefshme, asnjëherë mos u mundoni ta riparoni sistemin vetë.

Nëse hasni probleme ndërsa përdorni pajisjen, kontrolloni pikat e mëposhtme para se të kërkon shërbime. Nëse problemi mbetet i pazgjidhur, shkoni te faqja e internetit të Philips. (www.philips.com/support).

Kur kontaktoni Philips, sigurohuni që pajisja është pranë dhe që të keni në dispozicion numrin e modelit dhe numrin e serisë.

Nuk ndizet

- Sigurohuni që spina e energjisë AC e pajisjes të jetë lidhur siç duhet.
- Sigurohuni që ka energji në prizën AC.
- Për të kursyer energji, pajisja kalon automatikisht në gjendje joaktive 15 minuta pasi një luajtje arrin në fund dhe nuk lëvizet asnjë prej kontrolleve.

Nuk ka zë

- Rregulloni volumnin.

Pajisja nuk përgjigjet.

- Shkëputeni dhe lidheni përsëri spinën e energjisë AC, më pas ndizeni njësinë përsëri.

Disa skedarë që gjenden në pajisjen USB nuk shfaqen

- Numri i dosjeve ose skedarëve në pajisjen USB e ka kaluar një limit të caktuar. Ky fenomen nuk është defekt.
- Formatet e këtyre skedarëve nuk mbështeten.

Pajisja USB nuk mbështetet

- Pajisja USB nuk është e pajtueshme me njësinë. Provoni një tjetër.

Rreth pajisjes me Bluetooth

Cilësia e audios është e dobët pas lidhjes me një pajisje me Bluetooth

- Sinjali i Bluetooth është i dobët. Afrojeni më shumë këtë produkt ose hiqni çdo pengesë mes tyre.

Nuk është e mundur të bëhet lidhja me pajisjen

- Funkcioni Bluetooth i pajisjes nuk është aktivizuar. Referojuni manualit të përdorimit të pajisjes për mënyrën se si ta aktivizoni funksionin.
- Ky produkt është lidhur tashmë me një pajisje tjetër me Bluetooth. Shkëputeni atë pajisje dhe provoni përsëri.

Pajisja e çiftuar lidhet dhe shkëputet vazhdimisht

- Sinjali i Bluetooth është i dobët. Afrojeni më shumë këtë produkt ose hiqni çdo pengesë mes tyre.
- Për disa pajisje, lidhja e Bluetooth mund të çaktivizohet automatikisht si veçori e kursimit të energjisë. Kjo nuk do të thotë që ky produkt ka ndonjë defekt.

13 Njoftim

Deklarata e konformitetit

Çdo ndryshim ose modifikim i bërë në këtë pajisje që nuk është miratuar shprehimisht nga MMD Hong Kong Holding Limited mund ta bëjë të pavlefshme autoritetin e përdoruesit për ta përdorur pajisjen.

Ky produkt i përmbahet kërkesave të Komunitetit Evropian për interferencat radio. Këtu, MMD Hong Kong Holding Limited deklaron se produkti është në përputhje me kërkesat themelore dhe dispozitat e tjera të direktivës RED 2014/53/EU dhe Rregullores së Mbretërisë së Bashkuar për Pajisjet Radio SI 2017 Nr 1206. Deklaratën e konformitetit mund ta gjeni në www.philips.com/support.

Kujdesi për mjedisin

Hedhja e produktit të vjetër dhe e baterive



Produkti është projektuar dhe prodhuar me materiale dhe komponentë të cilësive së lartë të cilat mund të riciklohen dhe të ripërdoren.



Ky simbol në një produkt do të thotë që produkti mbulohet nga direktiva evropiane 2012/19/EU.



Ky simbol do të thotë se produkti përmban bateri që mbulohen nga Direktiva Evropiane 2013/56/EU të cilat nuk mund të hidhen së bashku me mbetjet e zakonshme shtëpiake. Informohuni lidhur me sistemet vendëse për grumbullimin e produkteve elektrike dhe elektronike dhe të baterive. Ndiqni rregullat vendëse dhe asnjëherë mos e hidhni produktin dhe bateritë së bashku me mbetjet e zakonshme shtëpiake.

Hedhja e duhur e produkteve të vjetra ndihmon në parandalimin e pasojave negative për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

Heqja e baterive njëpërdorimëshe

Për t'i hequr bateritë njëpërdorimëshe, shikoni pjesën për montimin e baterive.

Informacione mjedisore

Të gjitha paketimet e panevojshme janë hequr. Jemi përpjekur ta bëjmë paketimin që të ndahet me lehtësi në tre materiale: karton (kutia), polistirol (amortizuesi) dhe polietilen (qeset, fletë mbrojtëse sfungjeri). Sistemi përbëhet nga materiale të cilat mund të riciklohen dhe ripërdoren nëse çmontohen nga një kompani e specializuar. Ju lutemi ndiqni rregullat vendëse lidhur me hedhjen e materialeve të paketimit, baterive të konsumuara dhe pajisjeve të vjetra.

Njoftim për markën tregtare



Fjala dhe logot Bluetooth® janë marka të regjistruara tregtare që zotërohen nga Bluetooth SIG, Inc. dhe çdo përdorim i këtyre markave nga MMD Hong Kong Holding Limited bëhet me licencë. Markat e tjera tregtare dhe emrat e tjerë tregtarë u përkasin pronarëve të tyre përkatës.



Ky është një aparat i KLASIT II me izolim të dyfishtë, dhe nuk ka tokëzim mbrojtës.



Modelo: PVX931



08790-21-10947

Para maiores informações, consulte a site da ANATEL: www.anatel.gov.br
Este equipamento não tem direito à proteção contra interferência prejudicial
e não pode causar interferência em sistemas devidamente autorizados.
"Este produto contém a placa PVX931 código de homologação
08790-21-10947"

2021 © MMD Hong Kong Holding Limited. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Të dhënat mund të ndryshohen pa u njoftuar përpara.

Philips dhe Philips Shield Emblem janë marka tregtare të regjistruara të Koninklijke Philips N.V. dhe përdoren me licencë. Ky produkt është prodhuar nga, dhe shitet nën përgjegjësinë e MMD Hong Kong Holding Limited, ose të një prej filialeve të tij, dhe MMD Hong Kong Holding Limited është garantuesi i vetëm në lidhje me këtë produkt.

TAX5206_UM_V1.0

